



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova/ Republic of Kosovo**

**Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council**

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të neni 7, paragrafi 1, nënparagrafët 1.11, 1.31 dhe nenit 28 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 05/L-34 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, në mbledhjen e mbajtur më 2 nëntor 2021, miraton këtë:

**RREGULLORE NR. 02/2021**  
**PËR TRANSFERIMIN DHE AVANCIMIN E PROKURORËVE TË SHTETIT**

**Neni 1**  
**Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kriterëve dhe i procedurave për transferimin dhe avancimin e prokurorëve të shtetit.
2. Kjo rregullore zbatohet nga Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokurori i Shtetit, përfshirë të gjitha nivelet, në pajtim me Ligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe Ligjin për Prokurorin e Shtetit.

**Neni 2**  
**Shkurtesat dhe përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptimet si më poshtë:
  - 1.1. "KPK" - Këshillin Prokurorial të Kosovës;
  - 1.2. "PSH" - Prokurorin e Shtetit;
  - 1.3. "ZKPSH" - Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit;
  - 1.4. "Ligji" - Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës;
  - 1.5. "KPSH" - Kryeprokurori i Shtetit;
  - 1.6. "Kryeprokurori" - nënkupton kryeprokurorin e prokurorisë përkatëse;
  - 1.7. "PSRK" - Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës;
  - 1.8. "NJSHP" - Njësitin për Shqyrtimin e Përformancës së Prokurorisë;

- 1.9. **"Komisioni"** - nënkupton Komisionin për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorit të Shtetit;
- 1.10. **"Transferimi i përkohshëm"** - nënkupton transferimin e një prokurori me afat të kufizuar kohor;
- 1.11. **"Transferimi i jashtëzakonshëm"** - nënkupton transferimin të përkohshëm me kohë të caktuar;
- 1.12. **"Transferimi i përhershëm"** - nënkupton transferimin e një prokurori pa afat të caktua kohor;
- 1.13. **"Transferimi si masë disiplinore"** - nënkupton transferimin e përkohshëm ose të përhershëm si pasojë e masës disiplinore;
- 1.14. **"Avancimi"** - nënkupton ngritjen në detyrë në një nivel më të lartë të prokurorisë me vendim të Këshillit Prokurorial;
- 1.15. **"Departament i specializuar"** - nënkupton Departamentin e Krimeve të Rënda, Departamentin për të Mitur dhe departamentet e Prokurorisë Speciale.

### Neni 3

#### Parimet e procedurës së transferimit dhe avancimit

1. Procedura e transferimit dhe avancimit zbatohet duke u bazuar në parimet si në vijim:
  - 1.1. **Parimi i ligjshmërisë** - nënkupton që zhvillimi në karrierë, avancimi dhe transferimi i prokurorit duhet të bëhet duke u bazuar në ligj dhe në kriteret e kësaj rregulloreje.
  - 1.2. **Parimi i meritokracisë** - nënkupton që zhvillimi në karrierë, avancimi dhe transferimi i prokurorit duhet të bazohet në kritere objektive, siç janë: integriteti, aftësitë profesionale, përvoja profesionale, merita etj.
  - 1.3. **Parimi i mosdiskriminimit** - nënkupton që zhvillimi në karrierë, avancimi dhe duke përjashtuar mundësinë e diskriminimit, paragjytimeve në bazë të racës, gjuhës, gjinisë, religjionit, përkatësisë kombëtare etj.
  - 1.4. **Parimi i ruajtjes së fshehtësisë zyrtare** - nënkupton që secili prokuror apo stafi administrativ duhet të ruajë informatat në mënyrë konfidenciale, të cilat kanë të bëjnë me procesin e transferimit dhe avancimit.

## **Neni 4**

### **Llojet e transferimit**

1. Transferimi i prokurorit mund të jetë:
  - 1.1. i përkohshëm;
  - 1.2. i jashtëzakonshëm;
  - 1.3. i përhershëm dhe
  - 1.4. si sanksion disiplinor.

## **Neni 5**

### **Transferimi i përkohshëm nga KPK-ja**

1. Këshilli Prokurorial i Kosovës, pas paraqitjes së kërkesës nga Kryeprokurori i Prokurorisë apo Kryeprokurori i Shtetit, mund të transferojë një prokuror në një prokurori tjetër për një periudhë kohore jo më të gjatë se një (1) vit.
2. KPK-ja mund të transferojë në mënyrë të përkohshëm një prokuror, si në vijim:
  - 2.1. nga Departamenti i Prokurorisë Themelore në Departamentin e Prokurorisë Themelore të nivelit të njëjtë, por në prokurorinë tjetër;
  - 2.2. nga Departamenti për të Mitur i Prokurorisë Themelore në Departamentin për Krime të Rënda të Prokurorisë Themelore të njëjtë apo Prokurorisë tjetër ose anasjelltas, nga Departamenti i Krimeve të Rënda në Departamentin për të Mitur;
3. Kërkesa për transferim të përkohshëm duhet bërë me shkrim dhe duhet të ofrojë justifikimin e nevojshëm.

## **Neni 6**

### **Kriteret për transferim të përkohshëm**

1. Prokurori i Shtetit, i cili është kandidat për transferim të përkohshëm duhet të plotësojë kriteret, si në vijim:
  - 1.1. të jetë prokuror me mandat të përhershëm;
  - 1.2. të mos ketë të shqiptuar masë disiplinore, përjashtimisht vërejtjes jopublike dhe qortimit;
  - 1.3. te transferimi i përkohshëm duhet të plotësohet kriteri ligjor që kërkohet në prokurorinë, në të cilën është caktuar prokurori.

## **Neni 7**

### **Transferimi i jashtëzakonshëm**

1. Në rastet e jashtëzakonshme, Kryeprokurori i Shtetit mund ta caktojë përkohësisht një prokuror nga një prokurori në prokurorinë tjetër në pajtim me legjislacionin në fuqi.
2. Në rastin e transferimit të jashtëzakonshëm, prokurori duhet t'i plotësojë kriteret ligjore, të cilat kërkohen në prokurorinë në të cilën caktohet.

## **Neni 8**

### **Transferimi si masë disiplinore**

Ky transferim mund të bëhet si transferim i përkohshëm ose i përhershëm në një prokurori tjetër të nivelit më të ulët ose në një departament të një niveli më të ulët, si pasojë e shqiptimit të masës disiplinore, të paraparë me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

## **Neni 9**

### **Transferimi i përhershëm i prokurorëve nga KPK-ja**

1. Prokurori i Shtetit mund të transferohet në një prokurori tjetër në mënyrë të përhershëm dhe atë:
  - 1.1. nga Departamenti i Prokurorisë Themelore në Departamentin e Prokurorisë tjetër Themelore të nivelit të njëjtë;
  - 1.2. nga Departamenti për të Mitur i Prokurorisë Themelore në Departamentin për Krime të Rënda të Prokurorisë Themelore të njëjtë apo prokurorisë tjetër ose anasjelltas, dhe
  - 1.3. me vullnetin e prokurorit mund të transferohet nga departamenti më i lartë në atë me të ultë me vendim të KPK-së.

## **Neni 10**

### **Kriteret për transferim të përhershëm**

1. Për transferim të përhershëm, prokurori i shtetit duhet të plotësojë kriteret, si në vijim:
  - 1.1. të jetë prokuror me mandat të përhershëm;
  - 1.2. të mos ketë të shqiptuar masë disiplinore, përjashtimisht vërejtjes jopublike dhe qortimit, përveç nëse transferimi është bërë me vendim të Këshillit Prokurorial, si masë disiplinore;

- 1.3. të ketë vlerësim të performancës të mjaftueshëm ose më të lartë.
2. Komisioni merr parasysh me rastin e vendosjes për transferim të përhershëm edhe përvojën e punës dhe vendbanimin e kandidatit.
3. Me rastin e vendosjes për transferim të përhershëm merret edhe mendimi i kryeprokurorit të prokurorisë, nga e cila kërkohet transferimi.

### **Neni 11** **Avancimi i prokurorëve**

1. Prokurori i Shtetit, me vendim të Këshillit mund të avancohet në detyrë dhe atë:
  - 1.1. nga Departamenti i Përgjithshëm në Departamentin e Krimeve të Rënda apo për të Mitur brenda një Prokurorie Themelore apo prokurorisë tjetër themelore;
  - 1.2. nga Departamenti i Përgjithshëm apo ai i Krimeve të Rënda dhe për të Mitur i Prokurorisë Themelore në Prokurorinë Speciale;
  - 1.3. nga njëri departament i krimeve të rënda apo për të mitur, nga Prokuroria Themelore në Prokurorinë e Apelit;
  - 1.4. nga Departamentet e Prokurorisë Speciale në Prokurorinë e Apelit;
  - 1.5. nga njëri departament i Prokurorisë Themelore, Prokurorisë së Apelit apo Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit.

### **Neni 12** **Kriteret e përgjithshme për avancim**

1. Prokurorit i shtetit duhet të plotësojnë këto kritere për avancim:
  - 1.1. të jetë prokuror me mandat të përhershëm;
  - 1.2. të ketë vlerësim të mjaftueshëm ose më të lartë të performancës;
  - 1.3. të mos ketë masa disiplinore në pesë (5) vjetët e fundit, përjashtimisht qortimit dhe vërejtjes jopublike;
  - 1.4. të mos ketë filluar hetimi penal;
  - 1.5. të ketë reputacion të lartë profesional.
2. Me rastin e avancimit do të merren parasysh pjesëmarrja në trajnime në fushën specifike që ndërlidhet me njohuritë e përgjithshme në procedurë penale, mjetet

juridike, praktika juridike e gjykatave vendore dhe ndërkombëtare, përgatitja akademike, punimet shkencore, ligjërimi në akademi apo në nivel universitar, angazhimi i prokurorit në sistemin prokurorial dhe pjesëmarrja në projekte vendore ose ndërkombëtare në cilësinë e ekspertit dhe pjesëmarrja në ekipe hetuese.

### **Neni 13**

#### **Kriteret e veçanta për avancim**

1. Përveç kriterëve të përgjithshme duhet të plotësohen edhe kriteret e veçanta për avancim, si më poshtë:
  - 1.1. për ta ushtruar funksionin e prokurorit në Departamentin e Krimeve të Rënda apo në Departamentin për të Mitur në Prokurorinë Themelore, prokurori duhet të ketë mandat të përhershëm si prokuror;
  - 1.2. për të ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë e Apelit, prokurori duhet të ketë së paku pesë (5) vjet përvojë si prokuror, nga të cilat tri (3) vjet përvojë si prokuror në Departamentin e Specializuar të Prokurorisë Themelore ose në Prokurorinë Speciale të Republikës të Kosovës;
  - 1.3. për të ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, prokurori duhet t'i plotësojë kushtet për të punuar si prokuror në Departamentin për Krime të Rënda dhe
  - 1.4. për të ushtruar funksionin e prokurorit në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, prokurori duhet të ketë së paku shtatë (7) vjet përvojë si prokuror.

### **Neni 14**

#### **Shpallja e brendshme për transferim të përhershëm dhe avancim**

1. KPK-ja bën shpalljen e brendshme për plotësimin e pozitave të lira, e cila nuk mund të jetë më e shkurtër sesa 15 ditë.
2. KPK-ja fton të aplikojnë të gjithë prokurorët e interesuar, të cilët i plotësojnë kriteret ligjore për pozitat për transferim të përhershëm dhe avancim.
3. Shpallja e brendshme përcakton mënyrën e aplikimit.
4. Shpallja e pozitave për transferim të përhershëm dhe për avancim bëhet përmes uebfaqes zyrtare të sistemit prokurorial të Kosovës.
5. Për pozitat e lira për transferim të përhershëm dhe avancim, në rast të pensionimit të ndonjë prokurori, KPK-ja mund të bëjë shpalljen së paku tre (3) muaj para pensionimit të prokurorit.

6. Shpallja e brendshme për transferim të përhershëm dhe/ose avancim do të përfshijë informatat në vijim:
  - 6.1. numrin e vendeve të lira për transferim të përhershëm dhe/ose avancim dhe prokuroritë përkatëse;
  - 6.2. përshkrimin e pozitës;
  - 6.3. kriteret rreth kualifikimit për pozitën dhe
  - 6.4. afatin për dorëzimin e aplikacionit.

### **Neni 15**

#### **Procedura për transferim të përhershëm dhe avancim**

1. Pas shpalljes së brendshme nga KPK-ja, kandidati për transferim të përhershëm apo avancim duhet që brenda afatit prej 15 ditësh ta dorëzojë aplikacionin për transferim të përhershëm dhe avancim në KPK.
2. Aplikacioni mund të dërgohet me postë, personalisht ose në formë elektronike në Komisionin për Transferim dhe Avancim.
3. Komisioni do të shqyrtojë brenda 30 ditëve të gjitha aplikacionet e dorëzuara për të përcaktuar nëse kandidatët plotësojnë kriteret e parashikuara në ligj dhe me këtë rregullore.
4. Komisioni shqyrton të gjitha aplikacionet dhe dokumentet e dorëzuara në pajtim me shpalljen e brendshme për transferim të përhershëm apo avancim dhe të dhënat e ofruara nga komisionet përkatëse të KPK-së dhe Njësia përgjegjëse për menaxhimin e dosjes së prokurorëve.
5. Pas shqyrtimit të të gjitha të dhënave të kandidatëve, Komisioni harton një listë me të gjithë kandidatët që përmbushin kriteret për intervistim.
6. Nëse ka më shumë sesa një (1) prokuror që aplikon për transferim të përhershëm apo avancim për të njëjtën pozitë, Komisioni do të ftojë në intervistim të gjithë kandidatët, të cilët plotësojnë kriteret ligjore.
7. Komisioni njofton kandidatët për kohën e mbajtjes së intervistës, të cilët plotësojnë kriteret për transferim të përhershëm apo avancim, përbërjen e komisionit dhe të drejtën e kundërshtimit të ndonjërit nga anëtarët e komisionit në rast se kanë ndonjë konflikt interesi.
8. Intervista për transferim dhe avancim është e hapur për partneret bashkëpunues, me të cilët Këshilli ka marrëveshje.
9. Nëse ka vetëm një (1) prokuror kandidat që aplikon për transferim të përhershëm apo avancim dhe plotëson kriteret ligjore, të përcaktuara me këtë rregullore dhe Ligjin për Prokurorin e Shtetit për pozitën për të cilën aplikon, Komisioni i

proponon Këshillit për transferim të përhershëm pa e intervistuar prokurorin, ndërsa për avancim duhet të mbahet intervista e pastaj të bëhet propozimi.

10. Komisioni me rastin e poentimit të kandidatëve duhet të përdorë tabelat me sistemin e poentimit për kandidatët për transferim të përhershëm apo avancim, siç parashihet në aplikacion dhe formularin e poentimit, të cilat janë pjesë integrale të kësaj rregulloreje.
11. Komisioni njofton prokurorin për rezultatin e procesit të vlerësimit brenda shtatë (7) ditëve.
12. Komisioni harton raportin final me listën e kandidatëve të propozuar për transferim apo avancim, duke përfshirë edhe kandidatët e intervistuar të renditur sipas poentimit dhe i dërgohet KPK-së brenda shtatë (7) ditëve të punës.
13. KPK-ja do të vendosë me shumicë të thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm të Këshillit:
  - 13.1. të transferojë një prokuror në mënyrë të përhershme apo ta refuzojë transferimin;
  - 13.2. të avancojë një prokuror apo ta refuzojë avancimin.
14. Nëse KPK-ja vendosë për ta refuzuar kandidatin e propozuar për transferim apo avancim, vendimi për refuzim duhet të përmbajë arsyetimin e nevojshëm.
15. Vendimmarrja e Këshillit është me procedurë të njëjtë edhe te transferimi i përkohshëm, përveç transferimit të jashtëzakonshëm, të cilin e bën Kryeprokurori i Shtetit.

#### **Neni 16**

#### **Dokumentet në mbështetje të aplikacionit për transferim të përhershëm apo avancim**

1. Prokurori i shtetit që aplikon për transferim të përhershëm apo avancim duhet të dorëzojë edhe dokumentet, si në vijim:
  - 1.1. vlerësimin e kryeprokurorit të prokurorisë përkatëse për tre (3) vjetët e fundit;
  - 1.2. certifikatat e pjesëmarrjes në trajnime;
  - 1.3. dokumente apo të dhëna të tjera relevante objektivisht të verifikueshme, siç janë ato për njohjen e ndonjë gjuhe të huaj, mësimdhënia në nivel universitar, publikimet shkencore, pjesëmarrja në projekte vendore ose ndërkombëtare në cilësinë e ekspertit dhe pjesëmarrja në ekipe hetuese të përbashkëta.



**Neni 17**  
**Kompletimi i dosjeve për transferim dhe avancim të prokurorëve**

1. Në afat prej 15 ditësh nga dita e mbylljes së konkursit, Komisionit i paraqiten të dhënat për:
  - 1.1. përvojën e mëparshme të punës së kandidatit;
  - 1.2. trajnimet e ndjekura, të siguruara nga NJSHPP-ja;
  - 1.3. specializimin në lëmin e caktuar;
  - 1.4. masat disiplinore, të shqiptuara ndaj prokurorit;
  - 1.5. raportin i fundit të vlerësimit të performancës nga Komisioni për Vlerësimin e Performancës.
2. Komisioni mund të kërkojë informata shtesë nga prokurori, prokuroria apo nga komisionet përkatëse të KPK-së.

**Neni 18**  
**Heqja dorë nga transferimi i përhershëm dhe avancimi**

Në çdo kohë, deri në momentin e marrjes së vendimit të KPK-së, kandidati mund të heqë dorë nga procedurat e transferimit të përhershëm dhe avancimit, përveç transferimit, si masë disiplinore me vendim të Këshillit.

**Neni 19**  
**Komisioni për Transferim dhe Avancim të Prokurorëve**

1. Me qëllim të zbatimit të kësaj rregulloreje, KPK-ja themelon Komisionin për Transferim dhe Avancim të Prokurorëve, në bazë të kriterëve të përcaktuara me këtë rregullore.
2. Komisioni përbëhet nga tre (3) anëtarë, si në vijim:
  - 2.1. Kryeprokurori i Shtetit, i cili do të jetë kryesues;
  - 2.2. një anëtar nga radhët e anëtarëve të Këshillit dhe
  - 2.3. një prokuror nga Prokuroria e Apelit.
3. Komisioni do të ketë anëtarët rezervë sipas përbërjes në vijim:
  - 3.1. një prokuror nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit;
  - 3.2. një anëtar nga radhët e anëtarëve të Këshillit, dhe

3.3. një prokuror nga Prokuroria e Apelit.

4. Komisioni do të mbështetet nga zyrtari përgjegjës për emërim, avancim dhe transferim, i cili caktohet me vendim të KPK-së.

#### **Neni 20**

#### **Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit**

1. Komisioni ka mandat të përkohshëm dhe detyrat e tij janë të përcaktuara me këtë rregullore dhe ka këto detyra:
  - 1.1. Komisioni shqyrton të gjitha kërkesat dhe dokumentet e dorëzuara në pajtim me shpalljen e brendshme për transferim dhe avancim të prokurorëve dhe të dhënat e ofruara nga zyrtari përgjegjës për emërim, avancim dhe transferim e prokurorëve;
  - 1.2. Komisioni harton një listë me të gjithë kandidatët që përmbushin kriteret për transferim dhe avancim dhe i fton në intervistë;
  - 1.3. Komisioni harton raportin final me listën e kandidatëve të propozuar për transferim dhe avancim, pas intervistave në bazë të rezultateve të treguara dhe renditjes në bazë të poenëve, i cili dërgohet për miratim në KPK brenda shtatë (7) ditëve;
  - 1.4. kandidatët njoftohen për rezultatin e intervistimit dhe të drejtën e kundërshtimit në KPK;
  - 1.5. zyrtari përgjegjës për emërim, avancim dhe transferim të prokurorëve i ofron komisionit asistencë teknike gjatë tërë kohës.

#### **Neni 21**

#### **Kundërshtimi i prokurorit të shtetit ndaj njoftimit të Komisionit**

1. Kundër njoftimit përfundimtar të Komisionit për Transferim dhe Avancim, Prokurori i Shtetit ka të drejtë kundërshtimi me shkrim pranë KPK-së në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e pranimit të njoftimit.
2. Kundërshtimi duhet të përmbajë arsyet procedurale se përse nuk është pajtuar me vlerësimin e Komisionit, përfshirë shkeljet eventuale që konsideron se janë bërë sipas rregullores.

#### **Neni 22**

#### **Vendimi i KPK-së për kundërshtimin**

1. KPK-ja do të vendosë për kundërshtimin brenda dhjetë (10) ditëve nga dita e pranimit të kundërshtimit ose në takimin e parë të KPK-së, por jo më vonë sesa 30 ditë pune nga dita e pranimit të kundërshtimit.

2. Nëse vendimi i KPK-së rezulton që të pranojë kundërshtimin e prokurorit për transferim apo avancim, atëherë e obligon Komisionin që edhe njëherë ta vlerësojë raportin dhe të përgatitë raportin përfundimtar për Këshillin.
3. KPK-ja vendosë me shumicë të thjeshtë votash lidhur me avancimin apo transferimin e prokurorëve. Vendimi i KPK-së publikohet në faqen zyrtare të KPK-së dhe të PSH-së.

### **Neni 23** **Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare**

1. Formulari për vlerësim dhe formulari i aplikimit janë pjesë integrale të kësaj rregulloreje.
2. Vlerësimi "I mjaftueshëm" sipas Rregullores Nr. 12/2015 për Vlerësimin e Performancës të Prokurorëve të Shtetit është pengesë për avancim, deri në vlerësimin e prokurorit sipas Rregullores Nr. 05/2020 për Vlerësimin e Performancës të Prokurorëve të Shtetit.
3. Të gjitha proceset për transferim dhe avancim që kanë filluar para hyrjes në fuqi të kësaj rregullore do të vazhdojnë sipas Rregullores Nr. 03 /2016 për Transferim dhe Avancim e Prokurorëve.
4. Kjo rregullore shfuqizon Rregulloren Nr. 03/2016 për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit të datës 31.03.2016.

### **Neni 24** **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga KPK-ja.

Prishtinë, më 2 nëntor 2021

Jetish Maloku  
Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova/ Republic of Kosovo**  
**Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council**

---

**KOMISIONI PËR AVANCIM DHE TRANSFERIM TË PROKURORËVE TË  
SHTETIT**

SHTOJCA 2

Formulari për vlerësimin e Prokurorit të Shtetit

Data: \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_

**EMRI, MBIEMRI:**

**Pozita/departamenti aktual:**

**Kërkon avancim/transferim në:**

**INTERVISTIMI**

(Shpjegim i shkurtër në lidhje me intervistimin dhe poentimin e kandidatit)

--

**Tabela e poentimit**

Nr.	Kriteret	Maksimumi i pikëve	Vlerësimi
1	VLERËSIMI I PERFORMANCËS SË PROKURORIT ( vlerësimi i dalluar 35 pikë ) ( vlerësimi i mirë 25 pikë ) ( vlerësimi i mjaftueshëm 15 pikë )	Deri 35	
2	INTERVISTIMI	Deri 25	
3	PËRVOJA E PUNËS	Deri 20	
4	TRAJNIMET	Deri 10	
5	SPECIALIZIMET	Deri 10	
<b>GJITHËSEJ:</b>		<b>100</b>	

**Kryesuesi i Komisionit Vlerësues:**

\_\_\_\_\_  
*Emri dhe mbiemri*

\_\_\_\_\_  
*Nënshkrimi*

\_\_\_\_\_  
*Data*

**Anëtari i Komisionit Vlerësues :**

\_\_\_\_\_  
*Emri dhe mbiemri*

\_\_\_\_\_  
*Nënshkrimi*

\_\_\_\_\_  
*Data*

**Anëtari i Komisionit Vlerësues:**

\_\_\_\_\_  
*Emri dhe mbiemri*

\_\_\_\_\_  
*Nënshkrimi*

\_\_\_\_\_  
*Data*



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova/ Republic of Kosovo**  
**Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council**

**FORMULARI PËR AVANCIM/TRANSFERIM TË PROKURORËVE TË SHTETIT**

Datë: \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_

1. PROKURORI I SHTETIT (EMRI MBIEMRI):			
<b>KËRKON</b>	<input type="checkbox"/> AVANCIM		
	<input type="checkbox"/> TRANSFERIM I PERHERSHËM		
<b>Nga:</b>		<b>Në:</b>	
Arsyet e kërkesës për avancim/transferim të përhershëm:			

2. PËRVOJA E PUNËS
Përshkrim i gjithë përvojës së punës:

3. VLERËSIMET E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E PERFORMANCES SË PROKURORËVE		
Shënoni notën e vlerësimit/eve nga Komisioni për Vlerësimin e Performancës:		
Vlerësimet	Periudha vlerësuese	Nota e vlerësimit
Vlerësimi i parë:		
Vlerësimi i dytë:		
Vlerësimi i tretë:		
<b>Shto sipas nevojës!</b>		
A keni bërë kundërshtim ndaj vlerësimeve, nëse po jep detajet:		

4. STATISTIKAT					
Numri i rasteve të pranuar në punë dhe të përfunduara gjatë tri vjetëve të fundit:					
Viti	Llojet e lëndëve	Të bartura	Të pranuar	Të përfunduara	Të mbetura
2019					

2020					
2021					

5. NGRITJET AKADEMIKE:					
Shënoni ngritjet akademike:					
Universiteti		Qyteti		Shteti	
Fakulteti		Drejtimi			
Data e përfundimit:					
Shto sipas nevojës!					

6. TRAJNIMET	
Shënoni vetëm trajnimet e ndjekura, të cilat vlerësohen për pozitën në të cilën avancoheni:	
Vendi	
Organizatori	
Titulli i trajnimit	
Shto sipas nevojës!	

DEKLARIMI DHE KONFIRMIMI	
Me anë të nënshkrimit tim, unë deklaroj se:	
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Informatat në këtë formular aplikimi janë të vërteta dhe të sakta, si dhe janë bërë nën përgjegjësinë për deklaram të rrejshëm;</li> <li>• E autorizoj Këshillin Prokurorial të Kosovës për t'i verifikuar këto informata;</li> <li>• Jam i vetëdijshëm se për çdo deklaram të rrejshëm në këtë formular aplikimi, unë do ta humb të drejtën e avancimit dhe transferimit të përhershëm për pozitën e shpallur.</li> </ul>	
Nënshkrimi: _____	Datë: _____

**APLIKACIONI I PAKOMPLETUARAR NUK DO TË VLERËSOHET NGA KOMISIONI PËR AVANCIM DHE TRANSFERIM**